



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 389/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Agim Aliu nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër vendimit për rezultatin përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet** si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Agim Aliu nga koalicioni PDK-AAK-NISMA,
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA në Vendvotimin 2521D/01D,
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit në Venvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.
- IV. Fetije Sadria** me nr. të letërnjoftimit 1230470495, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 2521D/01D, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.06.2017, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Agim Aliu, nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me të cilën pretendon se në vendvotimin 2521D/01D shkolla fillore “Ganimete Terbeshi”, nga rezultati përfundimtar i publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, ka 2 vota ndërsa në vendvotimet tjera në komunën e Ferizajit ka poseduar 60% të votave të koalicionit të cilit i përketë. Parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë gabim teknik dhe se votat e tij janë bartur tek kandidatja me nr.54 Ilirjana Gafurri dhe kërkon që të bëhet rinumërimi votave të këtij VV.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e provës si dëshmi ka bashkangjitur kopjen e FRK-së për vendvotimin 2521/D01D, në të cilin pretendon se ka pasur parregullsi dhe deklaratën e anëtarit të KVV-së të po të njëjtit VV.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 2521/D01D është konstatuar nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) -ja në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), se kandidati me nr. 55, Agim Aliu nga radhët e subjektit politik Koalicioni PDK-AAK-NISMA komuna e Ferizajit i cili ka poseduar 2 vota në FRK-në e vjetër e cila është plotësuar në VV 2521D/01D i ndërsa pas rinumërimit në QNR i njëjti i posedon 138 vota.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkitazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesueses së vendvotimit, për pjesëmarrjen në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidate dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, sepse Kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par.10 të LZP-së, Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesja e vendvotimit në fjalë, ka bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesës i janë regjistruar 2 vota në FRK, ndonëse pas hetimeve të bëra nga paneli është vërtetuar se i njëjti i posedon 138 vota.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 389/2017 më datën 02.07.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.